

Sinjalizime

Ekskluzive | Këta janë vëllezërit që u ndaluan pas plagosjes me armë në Prishtinë – i plagosuri pretendoi se qëllloi veten aksidentalisht



Sinjali.com

29 Korrik 2026 10:03



Dy vëllezër kanë përfunduar në ndalim nën dyshimin se janë përfshirë në incidentin me armë zjarri që ndodhi në orët e para të mëngjesit të 28 korrikut në rrugën “Xheladin Hana” në Prishtinë, ku mbeti i plagosur Kreshnik Maloku rreth 30-vjeç.

Burimet e Sinjalit bëjnë me dije se të ndaluarit janë Amar Xhemshiti rreth 37 vjeç dhe Amir Xhemshiti rreth 37-vjeç.

Sipas informacioneve, rasti është raportuar rreth orës 01:50, pasi Kreshnik Maloku ishte dërguar në QKUK me një plagë nga arma e zjarrit në këmbën e majtë.

Fillimisht, i plagosuri ka deklaruar para hetuesve se ishte vetëplagosur aksidentalisht me armë zjarri.

Megjithatë, hetimet e zhvilluara nga Policia kanë nxjerrë dyshime se para plagosjes kishte ndodhur një përleshje fizike mes viktimës dhe dy vëllezërve të dyshuar. Sipas dyshimeve të para, gjatë kësaj përleshjeje, Kreshnik Maloku dyshohet se është qëlluar aksidentalisht nga arma që e kishte me vete.



Lexo edhe

Ekskluzive | Këta janë të dyshuarit për plagosjen me armë para Picerisë “Doro” në Prishtinë



Në vendin e ngjarjes, njësitë policore kanë sekuestruar tri gëzhoja, ndërsa arma e zjarrit që dyshohet se është përdorur ende nuk është gjetur.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, pas intervistimit, Amar Xhemshiti dhe Amir Xhemshiti janë ndaluar për 48 orë, ndërsa rasti po hetohet për të sqaruar plotësisht rrethanat e incidentit.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

•

Policia

Prishtina

Armë

ndalim


Të tjera:

Ekskluzive | Këta janë tre të ndaluarit pas tragjedisë në objektin “Vëllezërit Asllani”, ku...

Sinjalizime

Policia qëllon për vdekje furgonin dhe të dyshuarin për sulmin me thikë në Berlin Pride

Evropë



Ekskluzive | Arrestohet i kërkuari për vjedhje të rënda, dyshohet për së paku dy raste

Sinjalizime

Ekskluzive | Plagosi aksidentalisht babanë me armë zjarri në Skenderaj – 36-vjeçari...

Sinjalizime

Ekskluzive | Goditet skema e ryshfetit për lejeqëndrime – këta janë zyrtarët dhe biznesme...

Sinjalizime

Ekskluzive | Këta janë tre të arrestuarit që dyshohen për një seri vjedhjesh në Obiliq – u...

Sinjalizime

Policia e konfirmon për Sinjalin se polici 35-vjeçar dyshohet se ka kryer vetëvrasje

Siguri

Plagosje, përleshje dhe të shtëna me armë zjarri, policia arreston dy persona në Pejë

Siguri

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtesë
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera

